



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.11.2024, ora 13:00

TRYEZË TEMATIKE PUBLIKE VIII

Drejton tryezën: Emilio Çika

Rendi i ditës:

Forcimi i rolit mbikëqyrës, koordinues dhe monitorues i Kuvendit, duke respektuar parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, si dhe përmirësimi i funksionit zgjedhës të Kuvendit, duke respektuar parimet e meritokracisë, transparencës dhe paanshmërisë.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Klotilda Bushka, Julia Çela, Julia Done, Merita Qato, Mimoza Arbi dhe Elda Zenelaj.

Të ftuar:

Gledis Gjipali, Tomi Frashëri, Gentiana Sula, Erinda Balanca, Juljan Hysomema, Aurela Anastasi, Denar Biba, Erion Tase, Altin Shumeli, Elvin Gjevori, Besnik Dervishi, Taulant Balla, Vangjel Demi, Klesta Hysi, Agnus Bernhard, Rinor Beka, Mauro Puzzo, Majlinda Dhuka, Klodiana Vogli, Ilvana Dedja, Marjel Frroku, Juelda Lamçe, Elsonida Rama, Arvena Deda, Teis Kurti, Isabelle Thomas Delic, Kristian Lika, Xhejni Ruli, Migena Konda, Emilio Çika, Iris Luarasi, Laureta Mema, Blerian Celoaliaj, Reald Keta, Erlinda Lala, Roland Stafa, Loren Kaçollari, Stela Suloti, Juljan Hysomema, Seona Kolaveri, Agim Rrapaj, Albina Husanaj, Ardita Seknaj, Endri Teta, Holta Muka, Ema Kovanoj, Esmeralda Hoxha dhe Marcela Muke.

HAPET MBLEDHJA

Emilio Çika – I nderuar kryetar i komisionit, zoti Xhafaj,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve të pavarura,

Të nderuar përfaqësues të trupit diplomatik,

Përfaqësues të shoqërisë civile,

Të nderuar pjesëmarrës të tryezës,

Faleminderit për pjesëmarrjen!

Përpara se të filloj me prezantimin e tematikave, me të cilat grupi ynë është marrë gjatë analizës së tij, në radhë të parë dua të falënderoj drejtuesen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, zonjën Klotilda Bushka, për ndihmën e dhënë, si dhe zonjën Elda Zenelaj për ndihmën teknike dhe vënien në dispozicion të dokumentacioneve të kërkuara nga grupi i punës.

Unë quhem Emilio Çika dhe jam zëvendësdekan i Fakultetit të Shkencave Humane dhe të Drejtësisë në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë.

Së bashku me kolegët, Gledisin, Elonën dhe Kristin, kemi punuar mbi analizën e shtyllës së tretë, “Sundimi i ligjit”, dhe fushën “Funkcionet e Kuvendit, roli mbikëqyrës dhe monitorues” dhe veçanërisht në rolin mbikëqyrës, koordinues dhe monitorues të Kuvendit, duke respektuar parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, si edhe analizën mbi zgjedhjen e institucioneve të pavarura.

Dokumenti paraprak i paraqitur komisionit, i cili do të analizohet nga kolegu Gledis Gjipali, është përgatitur duke u bazuar parësisht në raportet vjetore të Komisionit European, në raportet *screening*, raportet e shtetit të së drejtës, raportet e veprimtarisë së Kuvendit, të shoqërisë civile, si dhe analizat apo kontributin e Akademisë dhe të botës akademike.

Duke qenë se dy nënpikat që kemi analizuar janë në një vazhdimësi dhe në mbështetje të njëra-tjetrës, analiza e tyre do të kryhet së bashku dhe më pas jeni të mirëpritur për sesionin e komenteve, debatit dhe pyetjeve.

Ju faleminderit!

Gledis, ke detyrën e vështirë për të paraqitur analizën.

Faleminderit!

Gledis Gjipali – Faleminderit, Emilio!

Faleminderit të gjithë grupit të ekspertëve me të cilët kemi punuar!

Siç Emilio e përmendi, pjesa mbi të cilën jemi bazuar ka të bëjë me raportet, të paktën e 2 vjetëve të fundit, mbi rolin e Parlamentit, rolin e institucioneve të pavarura, të Komisionit Europian, pozicionin negociues, raportin *screening*, po ashtu raporte të tjera të rëndësishme të organizatave ndërkombëtare, të cilat trajtojnë çështjet e funksionimit të Parlamentit, të ndarjes së pushteteve dhe rolit që kanë institucionet e pavarura dhe se si mundet të përmirësohet ky rol, duke pasur parasysh instrumentet që kemi në dorë, duke u bazuar te Kushtetuta e vendit, por duke parë edhe procesin e integritetit, anëtarësimin tashmë në Bashkimin Europian, se si i influencon këto institucione, si influencon legjislacionin, kuadrin rregullator, po ashtu dhe sjelljen tonë si shoqëri ndaj këtyre institucioneve.

Pa humbur kohë, do të kaloj në prezantim. Jam përpjekur për ta paraqitur sa më shkurt, sepse çështjet janë të rëndësishme. ka gjetje specifike për institucione specifike, por ne jemi përpjekur për të ndalur tek ato elemente të përgjithshme, në kuptimin që të gjitha institucionet preken nga këto elemente, janë tipare të përgjithshme të funksionimit të institucioneve dhe të Kuvendit në Shqipëri, pa u ndalur në specifika që mund të trajtohen më vonë gjatë fazave të mëtejshme të punës. Pra, nuk duam të ndalemi te veçoritë, por te përgjithësimet më shumë, për të trajtuar ato elemente që mund të adresohen dhe të kenë një efekt sa më të gjerë.

Çështjet në fokus të raportit dhe të këtij prezantimi për sa i takon pikës së parë lidhen me efektivitetin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj pushtetit ekzekutiv, përfshirë agjencitë ekzekutive, institucionet e varësisë, si dhe institucionet e pavarura. Po ashtu, kemi trajtuar dhe analizuar kuadrin monitorues, procedurat, standardet e përdorura të mbikëqyrjes parlamentare për performancën e veprimtarisë së qeverisë dhe institucioneve të varësisë, institucionet e pavarura, si dhe mbikëqyrjen periodike të zbatimit të rekomandimeve të tyre, që është një veçori dhe një element i rëndësishëm ku kemi ndaluar, mekanizmat për monitorimin e zbatimit të legjislacionit pas miratimit, po ashtu janë shumë të rëndësishëm, sepse tregojnë edhe funksionimin e këtyre institucioneve, gjetje mbi funksionimin e koordinimit institucional me në qendër Kuvendin, si dhe aspekte të monitorimit dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të ndryshme, që prodhojnë rekomandime të tilla, të cilat do të duhet të zbatohen dhe mbikëqyren nga Kuvendi, por jo vetëm.

Sigurisht që kontekstin e njohim të gjithë. Dua të ndalem te roli që ka Kuvendi në mbikëqyrjen dhe monitorimin e institucioneve të pavarura, rolin që Kuvendi ka sipas Kushtetutës së Shqipërisë në ndarjen dhe balancimin e pushteteve. Mendoj se që kuadri ligjor për funksionimin

e institucioneve të pavarura në Shqipëri përputhet me standardet ndërkombëtare, të njohura si “Parimet e Parisit”. Kështu që, ky kuadër u mundëson këtyre institucioneve të përmbushin detyrat e tyre, por sigurisht që, edhe nga vlerësime të ndryshme të bëra, ka nevojë për forcim të mëtijshëm të mbikëqyrjes parlamentare.

Një pjesë e këtyre institucioneve të pavarura japin rekomandime për përmirësim të funksionimit të ekzekutivit, por shpesh nuk kanë kompetenca të plota për të detyruar zbatimin e tyre, për ndjekjen e tyre, duke e bërë rolin mbikëqyrës të Kuvendit thelbësor në funksionimin e tyre.

Cilat janë problematikat e identifikuar? Përsëri jemi përpjekur për t’i trajtuar shkurt, sepse të gjithë ne i njohim. Nuk është se kemi problematika të reja, por problematika që janë zhvilluar ndër vite, të cilat janë identifikuar në raportin e Bashkimit Europian, në raportin *screening*, dhe po ashtu edhe në pozicionin negociues të përbashkët, ku vërehet një ushtrim burokratik. Pra, mbikëqyrja parlamentare shpesh kthehet në një ushtrim burokratik dhe të kufizuar vetëm në shqyrtimin e raporteve vjetore. Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga auditet e jashtme mbetet i ulët dhe si rrjedhojë edhe shqyrtimi parlamentar në këto çështje është ende i kufizuar.

Rekomandohet, sipas këtyre raporteve, rritja e numrit të seancave dëgjimore dhe krijimi i një sistemi më të mirë monitorimi për të vlerësuar punën e ekzekutivit. Po ashtu, në pozicionin e përbashkët negociues të Bashkimit Europian, me hapjen e grupkapitullit të parë të negociatave për anëtarësim është rritur rëndësia e forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe dialogut të hapur në Parlamentin shqiptar. Një Parlament funksional që mbikëqyr në mënyrë efektive qeverinë dhe punon në mënyrë gjithëpërfshirëse, është kyç për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Ritheksohet, gjithashtu, edhe nevoja e përdorimit më shumë të mekanizmave, si komisionet hetimore, për të përmirësuar rolin mbikëqyrës.

Disa nga masat konkrete të sugjeruara për përmirësimin e mbikëqyrjes lidhen me shqyrtimin ...

Pra, kryesisht këto janë masa që lidhen me aspektin teknik të punës së Kuvendit, lidhen me punën e Kuvendit dhe të shërbimeve të tij.

Ato janë: shqyrtimi nga Kuvendi dhe komisionet parlamentare i raporteve vjetore të institucionit, duke zbatuar të gjitha afatet ligjore dhe procedurat e duhura të raportimit; takimet periodike midis Kuvendit, institucioneve të pavarura dhe qeverisë, për përditësimin e platformës ndërinstitucionale *online* në lidhje me rekomandimet e institucioneve të pavarura, ndjekjen e tyre,

janë të nevojshme; zbatimi i mirë i mekanizmit ndërinstitucional qeveri-Kuvend-institucione të pavarura, që të ketë një monitorim sistematik dhe të vazhdueshëm të rekomandimeve, jo vetëm vjetor, por në tërësi për të gjithë setin e rekomandimeve; rikonfigurimi dhe zgjerimi i platformës ndërinstitucionale, për të përmirësuar transparencën dhe qasjen e publikut në të; shtimi, gjithashtu, i seancave dëgjimore për shqyrtimin e raporteve të institucioneve të pavarura, si dhe ngritja e një nënkomisioni për ndjekjen e raporteve të auditit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Një tjetër çështje me rëndësi e trajtuar ka të bëjë me problematikat e monitorimit të zbatimit të legjislacionit të Bashkimit Europian dhe të akteve normative, duke e ditur që ky proces i anëtarësimit të Shqipërisë kërkon reforma të thella, si rrjedhojë e një legjislacioni të ri apo legjislacioni të përmirësuar, duke e përafruar me atë të Bashkimit Europian, dhe të garantojë njëkohësisht zbatimin efektiv të tij.

Kuvendi i Shqipërisë, veçanërisht nëpërmjet Komisionit për Çështjet Europiane, luan një rol kyç në mbikëqyrjen e këtij procesi. Një komponent shumë i rëndësishëm është kontrolli postlegjislativ, i cili ka për qëllim vlerësimin e performancës së ligjeve pasi ato të kenë qenë në fuqi të paktën për 3 vjet. U dëgjua, në fakt, edhe në tryezat e mëparshme të ditëve të kaluara, ku ka pasur ecuri pozitive në përdorimin e këtij instrumenti, gjë që sigurisht ka nevojë për një aplikim më të gjerë dhe më të thellë në ato pjesë të legjislacionit, që janë shumë të rëndësishme edhe për procesin e integritetit europian.

Masat konkrete që lidhen me këtë problematikë kanë të bëjnë me forcimin e kapaciteteve të shërbimeve brenda Kuvendit (është një proces shumë intensiv, që do të intensifikohet edhe më tej, gjë që kërkon një përgjigje efektive nga ana e ngritjes së kapaciteteve për ta përballuar), kriteret më të qarta në përzgjedhjen e ligjeve që kalojnë në këtë kontroll postlegjislativ dhe përfshirjen e grupeve të interesit, të cilat mund të kontribuojnë në këtë proces, duke shërbyer, gjithashtu, edhe si një mjet informimi dhe komunikimi me këto grupe.

Si përfundim, si çështje për diskutim mbi këtë pikë kemi nxjerrë disa elemente. Siç e përmendi edhe Emilio në fillim, do të kemi të dy prezantimet dhe më pas do të kemi pjesën e diskutimit. Si fillim do të përmendja krijimin e një kuadri rregullator të përmirësuar për mbikëqyrjen e institucioneve dhe formalizimin e kriterëve për përzgjedhjen e ligjeve prioritare, dhe si nënçështje dëgjesat me përfaqësues të institucioneve që nuk kanë vepruar nga komisionet parlamentare, që ndjekin zbatimin e rekomandimeve (pra si çështje, të cilat do të adresojnë këto problematika, çfarë mund të bëhet) dhe detyrimin e institucioneve që nxjerrin rekomandime të

paraqesin raporte periodike mbi progresin e zbatimit të rekomandimeve dhe t'i bëjmë publike. Sigurisht, një pjesë prej tyre e bëjnë tashmë këtë publikim, por ka nevojë që të jetë në një shtrat të rregulluar dhe të gjitha institucioneve të veprojnë në të njëjtën mënyrë.

Elementet e tjera janë:

angazhim më i madh dhe pjesëmarrje e shoqërisë civile, medias apo grupeve të tjera të interesit, në monitorimin e zbatimit të këtyre rekomandimeve, me mundësinë për të krijuar një presion pozitiv publik mbi institucionet që nuk i neglizhojnë këto detyra;

mundësia e aplikimit të sanksioneve administrative ose disiplinore ndaj drejtuesve të institucioneve që nuk zbatojnë rekomandime kur nuk kanë arsye të forta, që edhe vazhdojnë të shmangin zbatimin e tyre. Po ashtu, një çështje tjetër për diskutim është edhe ideja e vlerësimit të performancës përmes buxhetimit me rezultate, sigurisht në atë masë që nuk prek cilësinë e shërbimeve publike në ato institucione që kanë detyrime përkundrejt qytetarëve dhe kjo pjesë, sigurisht, nuk mund të preket në rastet e aplikimit të tillë.

Do të vazhdoj, për efekt kohe dhe për të qenë sa më eficient, me pikën tjetër po në të njëjtën shtyllë: “Sundimi i ligjit, funksionimi i Parlamentit në një sistem demokratik”. Zgjedhja e institucioneve të pavarura. Në fokus të këtij raporti është analiza mbi proceset e zgjedhjeve të institucioneve të pavarura, duke respektuar parimet e meritokracisë, transparencës dhe paanshmërisë dhe, po ashtu, mekanizmat e mundshëm zhblllokues në rastet e mungesës së dialogut politik, të zgjedhjes së drejtuesve të institucioneve të pavarura, që është një problematikë e vazhdueshme e theksuar edhe në vitet e fundit. Kjo vjen nisur edhe nga raporte të ndryshme, të cilat e theksojnë. Do të citoj dy prej tyre.

Ndërkohë, siç e përmenda, analiza përqendrohet në dy çështje kryesore: përputhshmërinë e procesit të emërimeve me parimet e meritokracisë dhe transparencës dhe mekanizmat për zgjidhjen e bllokimeve politike. Pavarësia e institucioneve të pavarura është një element kyç në sistemin e ekuilibrit të institucioneve, të ndarjes së pushteteve. Raportet e Bashkimit European për Shqipërinë në 2 vjetët e fundit e kanë ngritur shqetësimin mbi ndikimin e partive politike në procesin e emërimit të drejtuesve të institucioneve të pavarura. Ndonëse reforma në drejtësi, procesi i vetëgjyqësorisë në veçanti, kanë përmirësuar sistemin gjyqësor, ka nevojë për reforma të ngjashme në emërimin e drejtuesve të institucioneve të tjera, për të aplikuar ato modele që funksionojnë dhe kanë dhënë rezultat.

Problematika, siç u përmend, kryesisht ka të bëjë me çështjen e meritokracisë, sa vlerësohet gjatë procesit të emërimit dhe të zgjedhjes së institucioneve të pavarura. Është vënë re që nominimet nga partitë politike dhe votimi në Kuvend shpesh bëhen pa një shqyrtim të hapur apo pa një kohë të mjaftueshme për të aplikuar këtë shqyrtim të hapur dhe të bazuar në meritë, duke ngritur shqetësime si për aspektin politik, pra në lidhje me besnikërinë politike, po ashtu edhe kompetencën profesionale, që në të dyja rastet cenojnë besueshmërinë e publikut ndaj këtyre institucioneve.

Shpesh proceset vonohen dhe këto janë përsëritur edhe në raportin vjetor të këtij viti të Komisionit European, duke ndikuar, për shkak të negociatave politike që nuk avancojnë, negativisht në pavarësinë dhe autoritetin e institucioneve, ku përmenden Avokati i Popullit, Autoriteti i Medieve Audiovizive në 2 vjetët e fundit, apo formula e përcaktimit të anëtarëve të ndryshëm për sa i takon Autoritetit të Medieve Audiovizive, që kaq ndikim partiak në këtë formulë. Për të përmirësuar këtë situatë, duhet adresuar transparenca në procesin e nominimeve veçanërisht, ku të ketë përfshirje të konsultimeve publike dhe debat të hapur. Po ashtu, edhe përfshirja e grupeve të interesit mund të ndihmojë në këtë proces.

Janë sugjeruar disa elemente se si mund të ndikohet procesi për t'u përmirësuar. Sigurisht, janë të gjitha tema për të cilat do të donim të dëgjonim komentet apo sugjerimet tuaja. Ne jemi fokusuar, siç e përmenda, në raportet e ndryshme të viteve të fundit, të cilat kanë theksuar elemente të veçanta dhe kemi trajtuar këto elemente të përgjithshme.

Elementi i parë ka të bëjë me krijimin e një kornize ligjore për emërimet e bazuara në meritë, ku mund të propozohet legjislacion specifik, që të përcaktojë qartë kualifikimet për kandidatët që shënojnë pozicione në drejtimin e institucioneve të pavarura. Këto kritere duhet të përfshijnë përvojë profesionale të matshme, kredenciale akademike të rëndësishme, kur nevojiten për fushën përkatëse, dhe sigurisht integritet të lartë, të verifikuar përmes një procesi të ngjashëm me vetingun që është realizuar në sistemin e drejtësisë, pra, duke marrë elemente, të cilat mund të jenë të vlefshme për këto institucione.

Mund të krijohet një sistem uniformë për nominimin, vetingun dhe emërimin e drejtuesve të institucioneve, ku i gjithë procesi duhet të përfshijë njoftime publike të hapura dhe në kohë, mundësinë për rishikime nga komitete apo komisione të pavarura me ekspertë të fushave përkatëse dhe më pas vendime përfundimtare nga Kuvendi të emërimit bazuar në lista të shkurtra të

përgatitura nga këto komitete, me arsyetime të detajuara për çdo përzgjedhje. Kjo do të ulte rrezikun e ndikimit politik dhe sigurisht që do të forconte meritokracinë.

Elementi tjetër ka të bëjë me prezantimin e mekanizmave të transparencës dhe kontrollit publik. Një i tillë është mbajtja e seancave dëgjimore publike me kandidatët e nominuar për të drejtuar institucionet e pavarura. Është një model që ndiqet në vende të ndryshe, ku kandidatët janë ata në listën e shkurtër, sepse mund të jetë një numër i madh kandidatësh, por pjesa që ka kaluar filtrin e parë mund të paraqiten në tryeza të hapura, ku mund të ketë diskutime dhe pyetje për të gjithë karrierën e tyre profesionale dhe përshtatshmërinë e mundshme me pozicionin e ofruar.

Këto seanca duhet të jenë të hapura, duke lejuar që shoqëria civile, aktorë interesi, media, gjithashtu, të shqyrtojnë dhe të japin komente dhe të bëjnë pyetje mbi kandidatët. Krijimi i një platforme të dedikuar mund ta lehtësonte këtë proces. Elementi i tretë ka të bëjë me forcimin e pavarësisë së procesit të emërimit. Siç e përmenda edhe pak më parë, krijimi i komisioneve të pavarura të përzgjedhjes do të ndihmonte për të ulur rrezikun e ndikimit politik në proces. Këto komisione do të përbëheshin nga anëtarë jopartiakë, përfshirë ekspertë nga Akademia, shoqëria civile, gjyqësori, fusha të ndryshme në varësi të specifikave, sigurisht, duke siguruar një vlerësim të drejtë dhe më objektiv të kandidatëve. Për të garantuar integritetin do të parashikohet, gjithashtu, që anëtarët e këtyre komisioneve të mos kenë role aktive politike, të kenë pasur apo të kenë për një periudhë të caktuar.

Gjithashtu, tjetër aspekt është edhe përbërja e komisioneve parlamentare, që sigurisht nevojiten të jenë sa më pluripartiake, për të përfaqësuar të gjithë spektrin apo sa më shumë të jetë e mundur spektrin politik parlamentar në përzgjedhjen e institucioneve dhe titullarëve të këtyre institucioneve.

Mekanizmat për zgjedhjen dhe bllokimet politike në emërime. Sigurisht është një temë apo çështje delikate dhe e veçantë, për faktin se nëse do të duhet të vendosen këta mekanizma zhbllokues, kur vetë qëllimi i mekanizmave është të detyrojë forcat politike të arrijnë një konsensus në këtë proces...

Do të theksoja që në këtë aspekt procesi i integritetit evropian është shumë i rëndësishëm për faktin se modelet europiane janë të bazuara te konsensusi, nuk janë të bazuara te bllokimi apo te forca e numrave për disa institucione që kanë një rëndësi të veçantë, që i takon një përzgjedhjeje më e gjerë sesa ajo që shpesh i jepet mazhorancës parlamentare.

Janë opsione të ndryshme për zgjidhjen e bllokimit, që mundet të diskutohen nëse pas një numri votimesh nuk arrihet. Mund të ketë një organ neutral të paracaktuar, si Gjykata Kushtetuese apo mund të jetë një komision i pavarur, i cili do të bëjë emërimin. Po ashtu, një element tjetër i rëndësishëm janë emërimet e përkohshme të drejtuesve, të cilat mund të parashikohen në rastet kur ka bllokim dhe kur institucioni rrezikon të mbetet pa drejtues apo të cenohet efektiviteti i vetë institucionit.

Një element me rëndësi i përmendur edhe më parë është përfshirja e shoqërisë civile, medias dhe grupeve të ndryshme të interesit, urdhrave të ndryshëm profesionalë. Nuk jemi detajuar për t'i përmendur të gjithë që mund të kenë interes, por në tërësi mund të përfshihen dhe të fuqizohen ligjërisht duke u përfshirë në procesin e nominimit apo edhe të emërimit. Realizohet nëpërmjet konsultimeve formale, për të cilat këta aktorë do të ofrojnë vlerësime të shkruara, të bazuara në merita, etikë, pavarësinë e tyre, integritetin e tyre, si dhe të përfshirjes së këtyre grupeve të interesit në komisionet e përzgjedhjes së pavarur.

Po ashtu, për sa i takon medias, ligji do të njohë rolin e medias si mbikëqyrëse e pavarur në procesin e emërimeve, duke ofruar një mbrojtje më të madhe për gazetarinë hulumtuese, për gazetarët në përgjithësi, të cilët të mos kenë frikë nga ndëshkimet politike, por, gjithashtu, edhe influencë politike.

Po ashtu, mbrojtja ndaj sinjalizuesve, që janë elemente të lidhura, paditë e ashtuquajtura SLAPP, strategjike, janë duke u trajtuar. Në fakt, janë një element mbi të cilat kohët e fundit ka një debat aktiv.

Trajnimi afatgjatë dhe ngritja e kapaciteteve si gjithmonë janë të rëndësishme, por në këtë rast ne i kemi përmendur edhe për titullarë të institucioneve të rëndësishme, të cilat kanë vazhdimisht pjesë legjislacioni, rishikim, sidomos në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian, por edhe për sa i takon aspektit të integritetit, etikës, që janë elemente shumë të rëndësishme dhe nuk duhen anashkaluar.

Në çështjet për diskutim, dy çështje kemi identifikuar tek elementi i zgjedhjes së institucioneve të pavarura. E para, ndikimi partiak në zgjedhjen e titullarëve apo anëtarëve të këtyre institucioneve, funksionimi dhe përdorimi i mekanizmave bllokues, pra sa funksionojnë, sa efektivë ata janë, cilat janë modelet që funksionojnë dhe jo, cilat janë praktikat e ndryshme europiane që mund të adaptohen, si dhe parashikimi i instrumenteve që bëjnë më transparent procesin brenda Kuvendit.

Çështja e dytë për diskutim ka të bëjë me adresimin e qëndrueshmërisë së institucioneve të tilla, kryesore, duke përcaktuar rregulla uniforme mbi kufizimin e mandatit, rizgjedhjen, qëndrimin në detyrë deri në emërimin e ri, shmangien e vakancave të tejzgjatura, e të tjera, me nënpika: zgjedhja automatike e zëvendësuesve apo emërimet të përkohshme brenda institucionit si ushtrues detyre, apo mundësia e vendosjes së afateve të detyrueshme për emërimet në rast të shkeljes së tyre dhe mbajtja e seancave të jashtëzakonshme për të përfunduar këto emërimet.

Këto janë çështjet për diskutim të dy pikave që trajtuam, si për sa i takon rolit të Kuvendit në sjelljen e institucioneve të pavarura, por, gjithashtu, edhe në ndjekjen e rekomandimeve të këtyre institucioneve, fuqizimin e tyre dhe rolin e tij mbikëqyrës ndaj ekzekutivit dhe institucioneve të tjera. Ndoshta u zgjata pak më shumë seç e kisha parashikuar.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Tashmë fjala është e hapur për të gjithë.

Emilio, faleminderit!

Emilio Çika – Faleminderit, Gledis!

Faleminderit për analizën edhe një herë!

Jemi përpjekur, ashtu siç tha edhe Gledisi, që të kryejmë një analizë kryesisht cilësore, duke bërë propozime në bazë të gjetjeve të raporteve, siç e thamë. Megjithatë, duhet thënë që analiza jonë nuk është shteruese, por përpiket të hedhë pikat për një debat, diskutime të mëtejshme apo propozime nga ana juaj dhe komente, sigurisht. Kështu që, jeni të ftuar për të bërë propozimet, komentet apo edhe pyetjet.

Faleminderit!

Tomi Frashëri – Faleminderit, zoti Çika!

Unë jam Tomi Frashëri, Kryetari i AKEP-it, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

I nderuar zoti kryetar,

Së pari, dua t'ju falënderoj për ftesën që institucionet e pavarura të marrin pjesë në punimet e këtij komisioni në mënyrë proaktive! Në fakt, kjo vjen paralelisht, në qoftë se mund ta them kështu, me ndërgjegjësimin më të madh të Kuvendit kohët e fundit për institucionet e pavarura. Zoti Gjevari është këtu dhe është i ngarkuar me një studim, në qoftë se mund ta them kështu, ose me një konsulencë nga Kuvendi i Shqipërisë lidhur me propozimet që mund të bëhen për rritjen e pavarësisë dhe efikasitetit të këtyre institucioneve. Kështu që mund të themi se jemi shumë të

kënaqur. Besoj se mund të flas edhe në emër të kolegëve, të paktën për këtë pikë, që jemi të përfshirë në reflektimin e përgjithshëm mbi zhvillimin ose evoluimin e institucioneve tona.

Thënë kjo, do të them disa gjëra shumë shkurtimisht në lidhje me çfarë u paraqit dhe me atë që mendon institucioni që unë përfaqësoj se duhet pasur parasysh, të paktën në një fazë të parë, për çështjet në diskutim, me qëllim që të merren parasysh gjërat konkrete, eventualisht për të përmirësuar, pikë së pari, çështjen e marrëdhënies së institucioneve të pavarura me Kuvendin; çështjen e raportimit, çështjen e llogaridhënies; çështjen e përgjegjësisë dhe, së dyti, një pjesë shumë pak të përfolur, në fakt, që ka të bëjë në mënyrë indirekte me emërimet.

Pikë së pari, dua të them se, ose do të doja të rekomandoja, që ky komision të kishte mundësinë të bënte edhe takime, le të themi, të individualizuara me institucionet e pavarura. Mendoj se është shumë e dobishme që anëtarët e këtij komisioni apo ekspertët që punojnë të njihen me realitetet e secilit institucion të pavarur, sepse ligji institucionet e pavarura nuk i kategorizon vetëm nga pikëpamja formale dhe organike si institucione të pavarura kushtetuese dhe institucione të pavarura të krijuara me ligj, por secili nga këto institucione ose secila nga këto kategori ka nënndarje të vetat; ka institucione rregullatore të tregjeve ekonomike, ka institucione që janë garante të të drejtave dhe lirive fundamentale dhe të tjera me radhë. Ka edhe institucione të gjyqësorit, sigurisht, siç dihet.

Kështu që mendoj se është diçka që ndoshta unë do ta rekomandoja apo AKEP-i do ta rekomandonte, që të përfshiheshin në agjendë takime teknike me secilin institucion të pavarur, sepse, të paktën nga sa pashë nga kjo përmbledhje ekzekutive shumë e kondensuar, kam një përshtypje që njohja e realitetit të institucioneve të pavarura është deri diku sipërfaqësore. Sfidat me të cilat përballen institucionet e pavarura, strukturat e tyre të brendshme, organizimi, financimi, misionet e reja që po u mirëbesohen nga legjislacionet europiane, të cilat ne i po përafrojmë me legjislacionin vendas, janë me një kadencë, po ndodhin me një kadencë relativisht të shpejtë dhe me raste nuk përkojnë me mjetet që u jep ligji këtyre institucioneve për të funksionuar siç duhet.

Tani, për dy pikat, që të mos marr shumë kohë, për sa i përket pjesës së llogaridhënies së institucioneve të pavarura, për mendimin tim duhet parë jo më shumë në kuadrin e një llogaridhënieje të thatë, por të një dialogu të vazhdueshëm. Fjala “dialog” është bërë pak fjalë e përdorur gjithandej dhe ndoshta nuk bën shumë sens, por nëse ka një kuptim mes institucioneve, ka pikërisht midis institucioneve të pavarura dhe Kuvendit, sepse llogaridhënia e institucioneve të pavarura është te Kuvendi. Kjo është një gjë shumë e rëndësishme.

E kam thënë në një takim të parë me Kryetaren e Kuvendit, para disa javësh, me të gjitha institucionet e pavarura: këmbëngul te fakti që dëgjesat janë fundamentale, dhe këtu i përshtesës prurjet e kësaj përmbledhjeje që u paraqit, dëgjesa që janë të natyrave të ndryshme, por mbi të gjitha për raportimin zyrtar të institucioneve të pavarura, ne këmbëngulim në faktin që duhet riparë mënyra, procedura konkrete e këtij raportimi.

Konkretisht, rekomandojmë që dëgjesat vjetore që janë zyrtare, e kam fjalën për raportimin zyrtar vjetor, ose të veprimtarisë vjetore të institucioneve të pavarura, duhet të ndodhin kryesisht në komisionin përkatës, duke shmangur, nëse është e mundur, një raportim totalisht formal në seancë plenare. Duke lënë mënjanë të gjitha konsideratat që kanë të bëjnë me faktin se kudo në botë, foltorja e Kuvendit u destinohet anëtarëve të Kuvendit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe nuk ka vend në botë, në Europë, akoma më pak, që në foltoren e seancës plenare paraqiten pafundësisht, duke rënduar agjendën e Kuvendit, Parlamentit, institucionet e pavarura dhe kur raportohet, zakonisht ka shumë pak deputetë në sallë, gjë që është, pak a shumë, paradoksale.

Ajo që vlen të merret në konsideratë janë dëgjesat më të hapura në komision, dëgjesat më gjithëpërfshirëse, ato *hearing* të famshmet, që janë diskutuar dhe ju i keni propozuar këtu kryesisht për propozimet ose kandidaturat, por që për mua duhet të jenë të përgjithshme për të gjitha çështjet e raportimit. Sigurisht, konfigurimi i këtyre dëgjesave mund të varet edhe në raport me rëndësinë e çështjeve që parashtrihen, por të paktën për raportet vjetore duhet të jenë dëgjesa gjithëpërfshirëse, ku patjetër mund të ketë më shumë deputetë sesa vetëm anëtarët e komisionit. Pra, kushdo deputet mund të marrë pjesë, mund të ketë edhe shoqëri civile, të gjithë ata që janë të interesuar për një llogaridhënie publike dhe të përgjegjshme.

Kështu që, kjo është diçka që unë marr lejen ose guxoj të ngul këmbë, edhe për të shtendosur agjendën parlamentare që mbingarkohet nga paraqitjet tona formale në seancë plenare, të cilat janë edhe të pafrytshme, sepse, edhe këtë është një gjë që dua ta theksoj: diskutimet që bëhen pas paraqitjes sonë në seancë plenare, janë diskutime ku titullarët nuk kanë të drejtë të përgjigjen, praktikisht. Kjo është diçka ku nuk kemi më dialog midis institucioneve të pavarura dhe Kuvendit. Dhe cilësia e diskutimit për rezolutën e Kuvendit që ju e përmendni dhe që është shumë e rëndësishme, sepse jep rekomandimet, është një udhërrëfyes për institucionet e pavarura, kthehet në një seancë ku diskutohen gjithfarë lloj gjërash të tjera përveçse rezoluta e institucioneve të pavarura, e cila vjen nga komisioni, miratohet si e tillë, por nuk ka pothuajse asnjëherë një debat

mbi relevancën e pikave të rezolutës. Pra, është siç vjen nga komisioni, sepse diskutohet për çfarëdolloj gjërash të tjera, por jo për atë. Atëherë, për ta bërë më të thjeshtë jetën e të gjithëve dhe më, le të themi, kuptimplotë, ne do të rekomandim që *hearing*-u apo dëgjesa në komisionin parlamentar të jetë vërtet shumë angazhuese për institucionet e pavarura. Absolutisht, shumë angazhuese, shumë serioze dhe të jetë më gjithëpërfshirëse dhe më me peshë. Kjo është çështja e parë për *hearing*-un.

Çështja e dytë ka të bëjë po me këtë pikë, me ndërveprimin përmes platformës. AKEP-i është një institucion që ka disa specificitete në lidhje me pjesën teknologjike. Ndoshta mund t'i japë edhe një ndihmë eventualisht komisionit për ta afinuar më mirë apo për ta sofistikuar më mirë këtë ndërveprimin konkret në platformën teknologjike. Gjithashtu, nga ana tjetër, do të rekomandonte që kjo platformë të shërbente jo vetëm si një dialog midis, tri partitë, mund të themi, qeveri - Kuvend - institucione të pavarura, por të përfshihej (prandaj thashë se institucionet e pavarura kanë shumë specificitete) edhe pushteti lokal në shumë raste, i cili ka një rol në ushtrimin e detyrave të disa institucioneve të pavarura dhe është ende pothuajse i pandërgjegjësuar për rolin që ka.

Nga ana tjetër, kjo platformë nuk duhet të shërbejë, sipas nesh, vetëm që të kontrollohen institucionet e pavarura nëse i kanë dorëzuar shkresat në kohë, në afat, dhe të tjera me radhë, që është gjë shumë e rëndësishme sigurisht, por që këto institucione të kenë mundësinë të depozitojnë aty qoftë ankesa për probleme të efikasitetit të bashkëpunimit institucional, qoftë propozimet e atypëratyshme për përmirësime kuadresh apo praktikash të mira midis institucioneve, që janë gjëra që mund të zgjidhen kollaj, por që rrallë adresohen në mënyrë efikase. Mendoj se është diçka që duhet menduar te kjo platformë. Nuk është thjesht pjesa e llogaridhënies, në mënyrë që të funksionojë bashkëpunimi institucional, por është edhe mundësia që institucionet, aty për aty, të adresojnë ankesa apo problematika për të cilat jo patjetër Kuvendit apo qeverisë mund t'i shkojë mendja apo t'i kenë prioritet.

Kjo për sa i përket kësaj pike.

Pika tjetër ka të bëjë me emërimet, dhe do ta mbyll këtu. Që emërimet të ndodhin duhet të ketë një herë lirim nga detyra të pararendësve në këto detyra. Ka një problem në mënyrën e të proceduarit, sot për sot, në çështjet e lirimit të drejtuesve të institucioneve të pavarura. Në raste të caktuara edhe AKEP-i është ndeshur me një lloj inercie të çuditshme, që konsiston në faktin që nuk ka asgjë në Rregulloren e Kuvendit, veç në mos gabohem unë, por besoj se e kam verifikuar

mirë, që ta saktësojë dhe ta bëjë transparente mënyrën se si ndodh lirimi nga detyra. Ka lirime për shkak të ligjit, që është dalja në pension e të tjera, që i notifikohen Kuvendit nga vetë autoriteti, por ka raste dorëheqjeje dhe ka raste shkarkimesh. Në rastin e dorëheqjes ndodh që praktikisht Parlamenti është inert. Parlamenti është ai që ka dhënë mandatin dhe Parlamenti, Kuvendi, duhet të konstatojë, në një farë mënyre që ky anëtar i funksioneve drejtuese e ka reshtur detyrën e tij. Ka ndodhur te ne që anëtari nuk largohej dot, nuk i bëhej dorëheqja efektive, sepse praktikisht nuk vinte asnjë shkresë nga Parlamenti për ta aktuar. Parlamenti e ka mandatuar, Parlamenti qoftë edhe për hir të paralelizmit të formave, duhet të thotë: po, detyra e tij ka reshtur, është pranuar dorëheqja. Detyrën e një anëtari të një bordi, të një organi kolegjal, nuk mundet ta konstatojë të mbyllur, të reshtur, titullari i atij institucioni, që është anëtar eventualisht i atij bordi, duhet ta bëjë Kuvendi. Këtu fillon efikasiteti dhe transparenca e emërimeve, sepse nga momentin kur ka afate për konstatimin e liritimit nga detyra, nga Kuvendi, ka afate pastaj për shpalljen e vakancës. Sot nuk ka afate për shpallje vakance dhe praktikisht nuk e dimë kur ka një vakancë në këshillin drejtues, praktikisht kur duhet bërë, një muaj para, dy muaj para, një javë para apo dhjetë ditë para. Nuk ka një rregullore për këtë, nuk ka një udhëzim apo nuk ka norma të qarta për këtë. Për mendimin tim, mendoj se kjo është diçka që vlen të adresohet në kuadrin e këtij studimi.

Kam një pyetje të fundit në lidhje me definicionin që ju keni për drejtuesit e institucioneve të pavarura. Kur ju flisni për drejtues dhe për dëgjesa të drejtuesve të institucioneve të pavarura, e keni fjalën vetëm për titullarët apo e keni fjalën dhe për anëtarët e këshillave drejtuese? Sepse një pjesë e këtyre institucioneve të pavarura, një pjesë shumë e madhe, funksionojnë si organe kolegjiale, pra me një këshill drejtues ose me një bord. Kur flisni për dëgjesa apo për sanksione ndaj drejtuesve, flisni vetëm për titullarin e këtij institucioni apo flisni edhe për anëtarët që janë vendimmarrës dhe kontrollues njëherazi të funksionimit të brendshëm të institucionit? Mendoj se kjo është një pyetje që meriton një përgjigje, duke pasur parasysh që të paktën deri më sot, le të themi, japin llogari për funksionimin e institucioneve në mënyrë publike në Kuvend vetëm titullarët. Ndërkohë, të gjithë anëtarët e një këshilli drejtues emërohen njësoj si titullari nga Kuvendi. Mendoj se ka vend për një sqarim këtu, domethënë për një përkufizim të qartë se cilët konsideroni ju, në kuadrin e kësaj pune, drejtues të institucioneve të pavarura, vetëm titullarin apo edhe anëtarët e këshillave drejtues?

Kërkoj ndjesë për kohën që mora, por është shumë stimuluese puna që keni bërë dhe shpresoj që do të vazhdojmë të jemi të përfshirë në këtë kuadër, për të dhënë mendime, për të shkëmbyer mendime.

Faleminderit!

Emilio Çika – Faleminderit, zoti Frashëri, për komentet!

Sugjerimet janë shumë të vlefshme, sigurisht edhe për pyetjen.

Do të doja që në vazhdimësi anëtarët ose pjesëmarrësit të jenë më të sintetizuar për të arritur kohën, në mënyrë që të gjithë të kemi mundësinë të adresojmë çështje.

Patjetër, ishte jashtëzakonisht shumë e vlefshme, sepse sugjerimet vijnë nga një drejtues institucioni dhe pikërisht edhe detajet janë ndonjëherë aty ku fshihet e gjithë çështja apo problematikat.

Faleminderit!

Fjala...

Gentiana Sula - Atëherë, së pari.

Emilio Çika – Më falni, të përgjigjet pak për pyetjen, sepse kalon koha më pas dhe harrohet pyetja.

Gledis Gjipali – Shkurtimisht. Në fakt, ideja është edhe për anëtarët, sepse edhe në prezantim u paraqit edhe çështja e dëgjësave, edhe emërimi i tyre. Në organet kolegjiale emërohen njësoj. Domethënë, njësoj kalojnë në Kuvend, njësoj votohet secili nga anëtarët, prandaj është e rëndësishme që edhe përgjegjësia të jetë individuale. Edhe më pas, në rastin e propozimeve për masa e të tjera, sigurisht që edhe vlerësimi do të duhet të jetë individual. Mund të qëllojë për organe kolegjiale ku vetë titullari është kundër një vendimi të marrë, por shumica ka vendosur një tjetër vendimmarrje. Pra, secili ka profilin e tij si në rastin e emërimit, ashtu edhe në rastin e vendosjeve, duhet të ketë një trajtim të tillë. Kjo ka qenë në kuptimin tonë, por sigurisht do të shohim më pas se si do zhvillohet.

Emilio Çika – Zonja Sula.

Gentiana Sula – Shkurtimisht, së pari, komplimente për punën e bërë!

Faleminderit organizatorëve, kryetarit, zonjës Bushka për mundësinë që të jemi këtu me ju dhe për të treguar se si ndihemi!

Kam dy-tri gjëra të vogla, sepse edhe zoti Frashëri ishte shterues.

E para, bie dakord me atë që institucionet tona janë shumë të ndryshme, kanë larmi, pavarësisht se ne jemi institucione të pavarura dhe na bashkon nevoja për paanshmëri, për mungesë të ndikimit politik, për eficiencë, për meritokraci. Në vetvete ne kemi fushat tona të veprimit, profilet tona, ligje organike dhe nuk mund të shihemi të gjithë shabllon. Kështu që, i qëndrojmë propozimit që u bë, dhe nëse ju e keni të mundur, ne jemi të hapur t'ju presim, të diskutojmë nga afër, edhe me anëtarët e organit kolegjal, se si ju mund ta përcillni atë qasje ku e shohim ne se mund të përmirësohen gjërat.

E dyta, ka të bëjë me rolin e qeverisë, që mund ta keni bërë në raportin e madh, por për kaq sa u njohëm ne besoj se ia vlen të preket. Për fat të mirë ka një Ministri për Marrëdhëniet me Parlamentin, por shpeshherë si organ kolegjal e ndiejmë nevojën që të avancojmë propozimet tona për vendime të qeverisë ose dhe të pushtetit vendor. Mendoj se kjo është diçka që duhet prekur, sepse është një strukturë institucionale.

Për sa u përket raportimeve, e preku pak zoti Frashëri, format i dinë edhe organizatorët, por, për shembull, në rastin tonë, ne na ka penalizuar fakti që rezoluta ka dalë në mes të vitit. Shpeshherë, duke qenë se del me vonesë, na vonon edhe ne në zbatimin e rekomandimeve. Në rastin tonë, varet shumë nga ne, nga rialokimi i fondeve, prioritarizojmë gjëra, forca, ndërkohë që gjashtë muaj kalojnë dhe e kemi të vështirë, sepse pastaj vjen dhe viti tjetër.

Diçka të fundit, që ka të bëjë me atë që ju e quani “meritokraci”, unë do të thosha se meritokracia lidhet edhe me motivimin për sa u përket emërimeve të kandidatëve më të mirë, që të ketë prurje sa më cilësore. Këtu besoj se ka vend për të biseduar për mënyrën se si motivohen burimet njerëzore që vijnë në këto pozicione kaq të larta, në institucione kaq specifike. Është vështirë të gjesh njerëzit e duhur për institucione kaq specifike. Por edhe duhen mbajtur, duhen mbajtur të motivuar njerëzit. Kur të bëjmë takime bilaterale, kemi një dy-tre propozime se si të mbahen njerëzit, edhe përmes një pakete benefitesh të caktuara, që të jetë kompetitive.

Shpeshherë, po flas këtu edhe për institucionet e tjera, për shembull, me zotin Biba folëm, bëhet fjalë për sektorin privat që është shumë konkurrues. Edhe në rastin tonë, për projekte shumë të rëndësishme që kemi, konkurrojmë për burime njerëzore. Kështu që të gjenden forma më inovative dhe jo aq shabllone, për të na lejuar t'i kemi duart më të lira, që t'i bëjmë, sepse kemi edhe mandat, edhe kohë të kufizuar, që të arrijmë objektivat tona, gjithmonë në funksion të eficiencës së punës.

Kaq, dhe komplimente! Puna të mbarë të gjithëve për t'i zbatuar këto!

Dhe e fundit, besoj se organi kolegjal na bashkon të gjithë, jemi të interesuar të gjithë. Ligji i organeve kolegiale është pak i vjetër edhe me siguri secili nga ne ka ide. Do të ishte e udhës që t'i merrni idetë tona dhe t'i adresojmë ndryshimet aty.

Në fund fare, ligji i organit kolegjal mendoj se duhet të adresojë çështjet e etikës. Ne kemi rregullore etike të gjithë, mirëpo është e vështirë për titullarët e institucioneve të sigurojnë një etikë të caktuar me anëtarë të organeve kolegiale që i sjell Kuvendi. Do të ishte e udhës që të ishte një instrument më i fortë se rregullorja e brendshme dhe parimet kryesore të etikës të ishin që në ligjin e organeve kolegiale.

Faleminderit!

Emilio Çika – Faleminderit, zonja Sula!

Zonja Avokate e Popullit.

Erinda Ballanca – Faleminderit!

Gjithashtu, edhe unë ju falënderoj për paraqitjen që bëtë, por më duhet të them se është i nevojshëm adresimi i problematikave të ndryshme për kategori të ndryshme institucionesh të pavarura. Megjithëse është bërë kjo ndarja e madhe, gjyqësori më vete dhe institucionet e tjera të pavarura më vete, përsëri brenda nesh ka vend jo vetëm për ndarjen kushtetuese dhe ligjore, por edhe për nga natyra dhe specificitetet.

Avokati i Popullit është shumë i lumtur kur shkon në Kuvend. Të them të drejtën, dëgjuesat e Avokatit të Popullit apo seancat e Avokatit të Popullit në Kuvend, përveçse në Komisionin e Ligjeve, kanë qenë seanca maratonë, prej dy ose tri orësh. Kjo tregon që unë i dua shumë seancat me debat në Kuvend. Kam qenë e shqetësuar vetëm në seancën e parë, kur kam raportuar në Kuvend, në kohë të pandemisë, kur nuk ka pasur pyetje. Vetëm atëherë jam ndier keq që ka qenë një seancë formale, por nëse seancat janë me pyetje dhe janë të mira, është një vlerë e shtuar, edhe për punën e institucioneve, por edhe për të adresuar pak atë fokusin e opinionit publik.

Për institucionin që unë drejtoj, kriteret e përzgjedhjes dhe cilësitë që duhet të ketë mënyra e përzgjedhjes së institucioneve janë të rregulluara në nivel ndërkombëtar. Besoj se dhe për kolegët duhet të ketë rregulla *guideline* të ngjashme për grupet e institucioneve të pavarura që ato përfaqësojnë apo, të themi, trajtohen në nivel ndërkombëtar. Prandaj, them që për secilin prej këtyre institucioneve, ajo që duhet të jetë e shkruar në këtë material, duhet të jetë që Shqipëria duhet të realizojë 100% përputhshmëri me standardet për fushat përkatëse.

Avokati i Popullit, edhe për shkak të mandatit të gjerë, ka dy *mega guidelines*. Parimet e Parisit, të cilat janë vetëm për Avokatin e Popullit dhe Parimet e Venecies, që janë për Avokatët e Popullit. Të parat janë për institutet e të drejtave të njeriut, mandat që ne e kemi dhe Avokatin e Popullit. Ndryshimet që janë bërë nga Komisioni i Venecies në ato *guidelines* janë shumë të rëndësishme dhe ne kemi nevojë ta ndryshojmë ligjin menjëherë, dhe aty, baza, merita është gjëja më kryesore. Pra, duhen procese që të jenë publike dhe me bazë merite.

Ndërsa, për sa i përket pastaj ndikimit politik, kjo është një çështje që zgjidhet vetëm me koshiençën e forcave politike dhe politikës. Nuk ka asnjë mekanizëm në botë, sado perfekt të jetë, që ta minimizojë ndikimin politik. Pra, procedura është një mënyrë që mund ta minimizojë ndikimin politik, por çdo avokat populli dhe çdo drejtues i institucioneve të të drejtave të njeriut, po them, në nivelin e atyre institucioneve që unë kam, ka një komponencë nëse vullneti është i parlamenteve dhe është një vullnet politik.

T'i vendosim ne kriteret që përjashtojnë mundësitë e atyre që kanë qenë aktivë në politikë, të personave që kanë qenë aktivë në politikë, të cilët nuk duhet të jenë më, dëgjesat, meritokracinë që është e padiskutuar, por ndikimi politik është i pamundur.

Unë e shikoj të vështirë, për shembull, që të argumentojmë faktin se ka më pak ndikim politik në qoftë se përzgjedhja është me pesëdhjetë plus një përqind të votave dhe me tre të pestat, siç mund ta ketë Avokati i Popullit. Sigurisht që ndikimi politik në zgjedhjen e Avokatit të Popullit, duke pasur një shumicë kaq të lartë tregon që duhet të jetë më i vogël, duhet të ketë konsensus.

Nga ana tjetër, ne po identifikohemi si një nga institucionet ku ndikimi politik është shumë i lartë. Çfarë ndodh me ato pesëdhjetë plus një? Domethënë, aty e vendos mazhoranca në të gjitha rastet? Pra, duhet të jemi më pak të kujdesshëm në identifikimin e problematikave.

Për sa u përket vakancave apo boshllëqeve në emërime, duhet diskutuar rast pas rasti me institucionet. Për institucionin që unë drejtoj, edhe për institucionin e komisionerit, edhe për shumë institucione të tjera, e ka zgjidhur ligji. Personi rri në detyrë derisa të emërohet tjetri, sepse është shumë i rëndësishëm funksionaliteti, *vis-a-vis*, i mandatit të përcaktuar kushtetues. Ky parim apo ky rregull është konsideruar praktika më e mirë në nivel ndërkombëtar si nga Komisioni i Venecies, ashtu edhe nga komitetet e Kombeve të Bashkuara në lidhje me institucionet që janë të ngjashme me Avokatin e Popullit apo me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Duhet të zgjidhet në mënyrë të padiskutuar përgjegjësia e personave, jo vetëm e titullarit. Pra, unë jam një institucion monokratit, kam fatin të jem një institucion monokratik, por, nga ana

tjetër, e kuptoj që edhe në të qenit monokratik ka vështirësi në lidhje me marrëdhëniet midis titullarit edhe pesë komisionerëve që unë kam të zgjedhur, po ashtu, nga Parlamenti. Është një vështirësi që ekziston, sepse për sa kohë ata i zgjedh Kuvendi dhe nuk kanë drejtpërsëdrejti...

Domethënë, fundësia e largimit do të ishte një procedurë, propozimi në Kuvend për t'i larguar do të ishte një sjellje shumë agresive e një titullari, *vis-a-vis*, një komisioneri, prandaj besoj se ka nevojë që të ketë një ligj të veçantë. Ndoshta jo ligjin e përgjithshëm të organeve kolegjiale, por të ketë një ligj të veçantë me specifikat përkatëse për organet kolegjiale dhe funksionimin e organeve kolegjiale në institucionet e pavarura, për shkak të kësaj natyre specifike që ne kemi dhe gjithmonë duke ruajtur vullnetin e Kuvendit në emërimin e tyre. Domethënë, përzgjedhja e komisionerëve të Avokatit të Popullit nga Kuvendi, nuk është për t'i vënë shkopinj nën rrota Avokatit, por është për t'i bërë ata të fortë ndaj administratës publike dhe për t'u treguar: shiko, se ky person është një person me mandat për administratën publike. Por, problemet kanë ndodhur dhe përgjegjësia është e Avokatit, ndërkohë që *benefici* është i komisionerit, herë pas here, kur kemi hasur probleme dhe na është dashur t'i adresojmë me mungesë, realisht me mosbërje të punës, mungesë fizike. Ka raste dhe ka njerëz që nuk janë fizikisht. Duhet të sillësh në një mënyrë të tillë që të shkosh përtej asaj që është sjellja e një bashkëpunimi luajal midis kolegësh.

Problemi tjetër që ne kemi dhe është shumë i rëndësishëm, është fakti që institucionet si modeli i institucionit të Avokatit të Popullit, kanë vetëm fuqi rekomandimi. Pra, niveli i zbatimeve të rekomandimeve të Avokatit të Popullit ndonëse është një nga matësit kryesorë, thelbësorë për nivelin e demokracisë, është i raportuar në çdo raport, përsëri mbetet në një nivel jo aty ku duam. Patjetër duhet parashikuar në këtë material një ndryshim i ri që ne duhet të bëjmë. E kemi detyrim edhe nga Këshilli i Europës. Për institucionet e të drejtave të njeriut, në vitin 2021 ka një rekomandim për këtë çështje. Të paktën, standardi është që institucionet nëse nuk i zbatojnë rekomandimet e Avokatit të Popullit duhet të kthejnë përgjigje të arsyetuara. Pra, gjoba për moskthim përgjigjeje, sepse ka dy kategori, moskthim përgjigjeje ose mospranim i rekomandimeve, por duhet gjobë nëse nuk kthejnë përgjigje fare dhe nëse nuk e pranojnë rekomandimin, duhet përgjigje e argumentuar.

Rekomandimi është i qartë, madje në vitin 2025 Këshilli i Europës do të bëjë një raport të përgjithshëm për të parë se ku janë vendet me ndryshimet, sepse të gjitha vendeve të Këshillit të Europës u është kërkuar të bëjnë ndryshime në lidhje me këtë çështje.

Thembra e Akilit në vitet në vijim do të jetë pushteti lokal. Kemi një hendek shumë të madh në vlerësimin tim midis përgjegjshmërisë dhe kuptimit të rolit të institucioneve të pavarura nga qeveria qendrore me pushtetin lokal. Në qoftë se me qeverinë qendrore, jemi 40%, 50%, të themi, të kënaqur, varet a je optimist apo jo.

Pushteti lokal është një dramë thelbësore e të qenit shtet brenda shtetit dhe e kanë përdorur, në vlerësimin tim, autonominë lokale në mënyrën më të keqe të mundshme. Dhe nuk kemi pothuajse fare mirëkuptim për atë që do të ndodhë, por kemi rekomandimet më pak të zbatuara të Avokatit të Popullit. Në fakt, nga pushteti lokal rekomandimet më të zbatuara të Avokatit të Popullit janë nga policia dhe burgjet. Mendojeni, domethënë, edhe nonsensin në kuptim dhe në koncept.

Këto ishin çështjet që kisha, por është e vërtetë që do të duhet të kemi takime individuale për të qenë më shterues secili për hallet e fushës së vet, le të themi, të njohurive.

Faleminderit!

Emilio Çika – Faleminderit, zonja Ballanca!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Juljan Hysomema – Jam Juljan Hysomema, përfaqësues i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në vijim të fjalës së zonjës Avokate të Popullit për rekomandimet, të katër pikat që ishin gjetur si zgjidhje janë në rastin kur rekomandimet nuk zbatohen, për më tepër kur nuk zbatohen rekomandimet e pranuar.

Ne, si Kontroll i Lartë i Shtetit, kemi vënë re një numër shumë të lartë të rekomandimeve të pranuar dhe një numër shumë të ulët të rekomandimeve të zbatuara. Dëgjuesat, detyrimi i institucioneve dhe sanksionet administrative ndaj drejtuesve vijnë pasi detyra nuk është bërë. Sepse të zbatosh rekomandimin është pjesë e detyrës sonë. E ke pranuar? Do ta zbatosh. Ndërsa cilësia e zbatimit është një gjë tjetër, sepse duke ardhur nga sektori i përfaqësimit në gjykatë ka shumë rekomandime tonat që rekomandojnë t'i drejtohen gjyqësorit për zgjidhjen e problematikës. Por kjo nuk mjafton me bërjen e një padie dhe mosparaqitjen në asnjë seancë gjyqësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky nuk është zbatim i rekomandimit, por bëhet sa për sy e faqe të popullit.

Për të ardhur pastaj te buxheti, rezultatet dhe sanksionimi, në qoftë se zbaton dy pikat e para, besoj, nuk do të ketë nevojë për të ardhur te dy pikat e fundit të gjetura nga kolegët.

Kaq kisha për të thënë për pjesën e rekomandimeve, meqenëse jemi institucioni që rekomandimin e ka bukë të përditshme, njësoj si zonja Avokate e Popullit.

Faleminderit!

Emilio Çika – Faleminderit!

Profesoreshë!

Aurela Anastasi – Faleminderit!

Më lejoni edhe mua t’ju përgëzoj për punën cilësore që keni kryer!

Të them të drejtën, e kam pasur kënaqësi të bashkëpunoj me ju.

Unë jam Aurela Anastasi dhe, në këtë kuadër, jam eksperte pikërisht në shtyllën “Sundimi i së drejtës”, por drejtoj komponentin “funksioni ligjvënës”.

Të bashkëpunoj me këtë komponent ishte padyshim tejet e frytshme dhe, të them të drejtën, gjatë bisedimeve tona paraprahe vumë re se ky komponent kishte më tepër vështirësi. Ka më shumë hapësirë, gjerësi dhe më tepër vështirësi teknike për të përmbushur të gjithë gjerësinë e kësaj fushe, edhe për faktin se jeni mjaft institucione të pavarura. Dhe, absolutisht, gjëja e parë që desha të thosha është që kategorizimi i tyre është shumë i rëndësishëm, sepse nevojat për reformim, pastaj, të marrëdhënieve midis Kuvendit dhe institucioneve të pavarura janë të ndryshme dhe varen shumë nga natyra e institucionit, nga ecuria që ai ka pasur deri tani.

Mjafton t’ju përmend se një ndarje mund të vijë nga burimi me të cilin janë krijuar dhe mund t’i ndajmë në institucione të pavarura kushtetuese dhe institucione të pavarura ligjore. Pastaj është fusha dikasteriale që ata mbulojnë, sepse janë institucione qendrore, pavarësisht se disa janë kushtetuese dhe disa ligjore, që i karakterizon ata. Dhe, natyrisht, e quaj me shumë vend propozimin e përfaqësuesve të nderuar këtu, që mendojnë se duhet kategorizuar puna jonë, pra e ekspertëve dhe duhen takime kokë më kokë, të paktën duke bërë një kategorizim të institucioneve të pavarura.

Dua të prek dy-tri çështje nga ato që janë evidentuar nga raporti dhe që i gjejmë fort të qarta në përmbledhjen që i është bërë raportit.

Unë, me kënaqësi, vura re se disa gjetje dhe disa formula që i kemi zbatuar në reformën në drejtësi janë marrë me qëllim që të adoptohen, jo të merren në mënyrë shabllone dhe të vendosen aty, por të adoptohen dhe të kenë rezultat edhe për zhvillimin më të mirë të vetë institucioneve të pavarura dhe të raportit midis Kuvendit dhe institucioneve të pavarura.

Për vetingun, natyrisht, do të thosha që duhet parë me kujdes, pavarësisht se ai mund të konsiderohet tashmë një veprimtari e suksesshme në kuadrin e zbatimit të reformës në drejtësi që po ecën, po shkon drejt përfundimit të tij.

Ka pasur rezultate, por kemi edhe rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe, duke pasur parasysh edhe natyrën e institucioneve të pavarura parlamentare, ne duhet të punojmë me shumë kujdes.

E para gjë që do të thosha, nuk ka veting si tek institucionet e drejtësisë, ka vetëm veting paraprak. Në qoftë se Kuvendi do të mbikëqyrë duke bërë vetingje sa herë Kuvendi e shpall me ligj që të kryejë veting ose vendos të kryejë veting, kjo do të thotë që i vendos ato institucione nën kthetra dhe ato nuk janë më institucione të pavarura. Këtu pastaj ne mund të flasim për ndikim politik ndaj institucioneve të pavarura.

Kështu që “veting” është fjala, por këtu bëhet fjalë për një veting paraprak, që lidhet drejtpërdrejt me procesin e emërimeve, që mendoj se është shumë i rëndësishëm. Prandaj, edhe një veting i menduar mirë do t’i shërbente procesit të emërimeve sikundër transparencës dhe korrektesës, normave të korrektesës në procesin e emërimeve, që folësit e nderuar i parashtruan këtu.

Pardje në Tryezën e Funksionit Ligjvënës i kushtuam rëndësi rritjes së besueshmërisë së Kuvendit nga publiku. Natyrisht, janë edhe aspekte të tjera, por edhe procesi i emërimeve dhe korrektesa e Kuvendit janë elemente shumë me peshë, sepse ose e rrisin besimin e publikut sot, ose e shkatërrojnë.

Institucione të pavarura që nuk po dihet se po respektojnë mandate, institucione të pavarura, që, kur vjen, nuk respekton mandatin e të tjerëve apo institucione të pavarura që vetë ata nuk komunikojnë dhe nuk krijojnë lidhjen me Kuvendin me qëllim që të respektohet procesi i emërimeve, natyrisht që e ulin shumë figurën e Kuvendit në besimin e publikut, po edhe të vetë institucione të pavarura. Fjala vjen, institucioni i pavarur duhet të ndihet përpara se mandati të ketë mbaruar, me qëllim që Kuvendi t’i fillojë procedurat më parë. Dhe, natyrisht, jam shumë dakord që duhet të ketë përmirësime, sidomos të Rregullores së Kuvendit, por edhe të legjislacionit, sepse janë institucione të pavarura të krijuara me ligj dhe aty mund të ketë parashikime që të vendosin procedurat për emërimet me qëllim korrektesën.

Vijmë te pjesa tjetër, që lidhet po me emërimet. Siç e shikojmë, jemi përqendruar tek emërimet këtu, sepse edhe fokusi ka të bëjë me marrëdhëniet dhe mbikëqyrjen e Parlamentit me

institucionet e pavarura, pa hyrë te veprimtaria e posaçme e institucioneve të pavarura. Në qoftë se vijmë te mekanizmat zhblllokues, në reformën në drejtësi patëm mjaft mekanizma zhblllokues, mbi 20 (gati 20 të tillë janë në Kushtetutë), por kemi edhe mekanizma zhblllokues në ligjet e organeve të drejtësisë.

Çfarë kemi vënë re në këta mekanizma zhblllokues?

Në radhë të parë, ne shikojmë që ata e eliminojnë krejt vullnetin politik dhe janë aty, sepse parashikohen si rast përjashtimor, jo si rast që të mbulojnë organet e emërtesës. Meqenëse vullneti politik ndonjëherë është i vështirë për t'u arritur, e kuptojmë që mund të zbatohen mekanizma zhblllokues, por në qoftë se Kuvendi nuk arrin asnjëherë konsensus, nuk ka pse e vë veten në ato detyra që nuk i arrin dot.

Çfarë vura re unë duke e studiuar sidomos zbatimin e mekanizmave zhblllokues në reformën në drejtësi? Unë vura re se ne po shndërroheshim, le të themi, në digjitalë, sepse kishim formula të mekanizmave zhblllokues të cilët janë automatikë, janë me short, dhe nesër inteligjenca artificiale ju zëvendëson më së miri. Tani, në qoftë se Kuvendi ka vendosur që një pjesë të funksioneve të tij t'ia falë inteligjencës artificiale dhe vetë le të katandiset ai që mund të katandiset, nuk e di. Prandaj Kuvendi duhet të mendojë shumë për këto raste: merr përsipër që të emërojë me konsensus, nuk arrin, por mekanizmat zhblllokues nuk mund të jenë aty për çdo rast. Mekanizmat zhblllokues janë raste përjashtimore, të paktën unë e shikoj këtë edhe nga teoria se edhe teoria në këtë pikë, sidomos me institucionet e pavarura, ka ecur mjaft.

Ne, madje, kemi pasur diskutim teorik edhe në lidhje me funksionin normativ që kanë institucionet e pavarura: kemi ushtrim të kontrollit incidental nga Gjykata e Lartë në Gjykatën Kushtetuese, ku Gjykata e Lartë ngrinte në vëmendje faktin që të drejtën për të nxjerrë akte normative e kanë vetëm institucionet e pavarura kushtetuese, ndërsa institucionet parlamentare të pavarura jo.

Mirëpo, nga ana tjetër, pikërisht ne, konstitucionalistët, këmbëngulim në faktin që institucionet e pavarura janë aty si një mjet shumë i rëndësishëm për të vendosur ekuilibra në ndarjen e pushteteve dhe për të dobësuar, le të themi, për të dobësuar pak fuqinë e tepruar të ekzekutivit dhe, sidomos, në republikat parlamentare si Shqipëria, për të cilat mjaft teoricienë thonë se ka vetëm dy pushtete.

Institucionet e pavarura janë aty institucione ekuilibri për një ndarje të mirë të pushteteve, kështu që ato duhet të kenë funksion normativ. Nuk e ndalim dot më ne tani që të themi: meqenëse

në Kushtetutë kemi thënë që aktet normative i nxjerrin vetëm organet e parashikuara nga Kushtetuta, nuk mund të nxjerrin akte normative institucionet e pavarura. Kjo duhet parë.

Mirë. Unë po ndalem këtu, sepse do të kemi raste të tjera.

Ju falënderoj shumë për vëmendjen!

Emilio Çika – Faleminderit shumë, profesoreshë!

Zoti Biba.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Denar Biba – Tamam, më gërrici nën lëkurën e vjetër.

Në fakt, nuk doja të flisja, por po kujtoja...

Jo, po kujtoja që, kur jam njohur me zotin Xhafaj, kam qenë në moshën, ndoshta, edhe të Ardianit dhe të Kristit, dhe zoti Xhafaj ka qenë pothuajse ekzaktësisht në moshën time sot. Dhe ky shift-i, nga ai raportuesi *desk-based*, pa njohur posaçërisht tokën, arën, pa e provuar, pa e njohur farën, sikundër për fat të mirë jam sot, bën diferencat. Edhe historia e karrierës që të kem qenë në disa organe të pavarura, në pozita të ndryshme, edhe...

Në fakt, do të doja ta shikoja të ishte këtu, nuk e di a e kemi të ftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, por edhe ILDKPKI-ja duhej të ishte këtu, si institucione të pavarura. Dhe është shumë e rëndësishme që në përfundim të raportit ta bëni sa më makro, po aq edhe në nënndarje, dallimin e jashtëzakonshëm që ka midis disa institucioneve të karakterit mbikëqyrës, *watchdog*, siç mund të jetë më i pari dhe nga të gjithë Kontrolli i Lartë i Shtetit, po ashtu Avokatura, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, edhe ILDKPKI-ja, nga institucionet pastaj të karakterit rregullator. Edhe këto bëjnë diferenca të jashtëzakonshme si në lidhje me mënyrën se si do të përzgjidhen anëtarët, edhe me mënyrën se si do të përzgjidhen drejtuesit e këtyre institucioneve.

Nuk e di pse sa herë ndodhemi në mjedise të tilla, bëhemi më katolikë se Papa, ku koncepti i politikës ndonjëherë ka edhe një lloj pikëpyetje, veçanërisht në medime të këtij karakteri politik, që janë thelbësisht politike, dhe konceptit politik i jepet një lloj konotacioni negativ. Nuk e shoh një gjë të tillë. Në qoftë se nuk jemi qenie politike, ne nuk jemi civilë, ne nuk jemi qytetarë, në radhë të parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, fakti që në institucione të ndryshme, rast pas rasti, sa më shumë ne shkojmë drejt gjyqësorit, nuk duhet të kemi eksperiencë të theksuara politike, është një gjë tjetër dhe se në momentin kur përzgjidhemi në institucione të këtij karakteri duhet të ndërpresim marrëdhënien

aktive (personalisht, nuk kam asnjë lloj shqetësimi, nuk kam qenë ndonjëherë anëtar partie), por edhe sikur individët të kenë pasur marrëdhënie të këtij karakteri, të vijnë nga bota e politikës, deputetë, ish-ministra dhe drejtues të tjerë institucionesh, ky vend është një vend me burime të pakta njerëzore dhe është një nga pasuritë më të mëdha që një komb ka, cilido komb.

Të arrish të përjashtosh, me një të rënë të lapsit, eksperiencën të tilla njerëzore, nuk e di, është fatalitet. Ne kemi luajtur vazhdimisht me veten me gjëra të tilla dhe nuk është se na ka dalë mirë. Ndaj duhet bërë një lloj *map*-imi i mirë i atyre se çfarë do të themi.

Në rast se do të vendosen kritere paraprake, le të mos përfundojmë që t'i zgjedhë, që ta përngjasojmë veten me inteligjencën artificiale.

Drejtuesit e institucioneve

Shumë prej institucioneve janë kolegjiale dhe nuk e di nëse ndonjëri nga ju ka punuar, por unë kam punuar gjithë jetën time në institucione kolegjiale, brenda në institucion ose këshilltar, ose pranë një institucioni, dhe kujtoj mbledhje të gjata, të cilat i përjetoj edhe sot me kolegët e mi, dhe diskutime të gjata. Dhe secili prej nesh aty në Autoritetin e Konkurrencës, në Komisionin e Konkurrencës, e konsideron veten personalitet, dhe respektë për të gjithë kolegët e mi, të cilët janë doktorë shkencash, profesorë shkencash dhe gjithkush ka opinionin e tij, saqë ndonjëherë mbledhjet tona zgjasin edhe nga 2-3 ditë, 2-3 mbledhje për një çështje të caktuar.

Të punosh në institucionet kolegjiale dhe të drejtosh një institucion kolegjial është edhe art më vete. Dhe fare mirë duhet pasur nga Kuvendi edhe një lloj këndvështrimi i tillë, posaçërisht për drejtuesin e institucionit, i cili në një mënyrë a një tjetër edhe unifikon dhe krijon marrëdhënie të caktuara për të krijuar kohezion, por edhe një lloj strukture sa më njerëzore brenda komisioneve që ai drejton.

Në marrëdhënie me Kuvendin, ndonjëherë biem pre e disa formalizmave.

Një pjesë e punëve tona të përvitshme diktohen nga Kuvendi i Republikës përmes rekomandimeve që Kuvendi i Republikës jep dhe ndodh ndonjëherë, dhe nuk është fare e çuditshme që ndodh, e çuditshme do të ishte të mos ndodhte, që na jepen rekomandime vështirë të arritshme, për ta thënë me eufemizëm, vështirë realisht... Nuk ka nevojë që ju të jeni ekspertë të së drejtës së konkurrencës, por, për shembull, jepet një rekomandim i tillë: të hetojë platformat digjitale. Për ata që nuk e dinë, platforma digjitale janë *TikTok*-u, *Youtube*-i, *Facebook*-u (*Meta*) dhe *Amazon*-i dhe Autoriteti i Konkurrencës në kapacitetet e veta e ka objektivisht të pamundur ta bëjë këtë, është i dështuar që në partencë, nuk ka nevojë fare as ta nisë.

Dhe ndërkohë që ne krijojmë një praktikë të mirë (dhe në këtë pikë e falënderoj zotin Shalsi, nuk është këtu, kryetarin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, komisionit të Kuvendit ndaj të cilit ne raportojmë për t'i diskutuar paraprakisht rekomandimet, pikërisht për të mos rënë në paradokse të këtij karakteri), kjo konsiderohet e papranueshme nga deputetë të tjerë, të cilët, nuk e di, me një lloj përmbyllje të Kuvendit, thonë: “Ne nuk mund t'i diskutojmë me institucionet e pavarura rekomandimet. Ne ua japim, ato duhet t'i zbatojnë”.

Nuk është kështu, sepse në thelbin tonë ekzistencial ne nuk jemi gjë tjetër veçse instrumente të Parlamentit. Supozohej që punën e Tomit apo timen ta bënte vetë Kuvendi, por nga momenti që kërkon kohë të dedikuar dhe specializim të jashtëzakonshëm ndonjëherë, ka zgjedhur, kjo është në kuptim të së drejtës kushtetuese, të filozofisë së gjësë, t'i identifikojë me këto lloj funksionesh institucionet e pavarura.

Atëherë, duke qenë se unë jam eksperti, edhe mënyra se si do të ndërveprojmë ne bashkë, që rekomandimet të jenë të arsyeshme dhe të efektshme duhet të jenë në respekt të këtij ndërveprimi dhe jo si detyra shtëpie që jepen nga mësuesja e gjithëditur për nxënësin e paditur, sepse, posaçërisht në këtë rast, funksionon ndryshe: ne kemi maksimumin e eksperiencës (pra, ne jemi nxënësi i gjithëditur), por natyrisht nuk kemi ngarkesë politike të Kuvendit dhe, patjetër, do t'i marrim detyrat nga Kuvendi.

Këto kisha pak a shumë, sepse kolegët i përfolën shumë gjëra.

Kështu që unë, patjetër, ju falënderoj për faktin që na keni ftuar dhe do ta quaja shumë të vlefshme, dhe jeni të mirëpritur në institucionet tona, t'i diskutojmë edhe në mënyrë më informale dhe më të posaçme, për të prekur edhe ju atë tokën dhe farën.

Faleminderit!

Emilio Çika – Ju falënderoj edhe unë, zoti Biba!

Zoti Tase.

Erion Tase – Mirëdita!

Unë jam Erion Tase dhe, pas institucioneve të pavarura, jam këtu, ndoshta jo me atë nostalgjinë e sallës, por si përfaqësues i shoqërisë civile dhe prej shumë vitesh kemi pasur bashkëpunime me Kuvendin edhe për të ofruar rekomandime dhe analiza të ndryshme.

E gjej me shumë interes këtë format që ka zgjedhur ky komision për të analizuar së jashtmi se si funksionojnë ato fusha që janë ndarë në objektivin e këtij komisioni dhe më pas për të dalë me rekomandime konkrete për t'u përkthyer në legjislacion të ri apo përmirësime të ndryshme.

Nga diskutimet këtu, pak a shumë edhe nga analiza juaj, komenti im i parë, edhe pse nuk kam qenë prezent në tryezat e tjera, do të ishte që analizat të ndaheshin paraprakisht, në mënyrë që të vinin me komente konkrete dhe me shkrim për ne si të ftuar, për të qenë pjesë e tryezave.

Së dyti, rekomandimet e dhëna nga analiza në lidhje me përmirësimet ligjore për mënyrën se si emërohen dhe si funksionojnë institucionet e pavarura, unë do ta shikoja pak a shumë edhe nga eksperiencia, edhe te pjesa se si vetë Parlamenti është i përgatitur për të rritur rolin e tij mbikëqyrës, përtej detyrimeve që ka, raporteve vjetore që organizoni ju si institucione apo në institucione të tjera, për t'i bërë ato jo vetëm formale, por edhe sa më profesionale.

Aktualisht, meqenëse jemi këtu në Kuvend dhe në komision, ne kemi deputetë shumë të përgatitur që janë të ndarë në komisionet përkatëse dhe organizojnë diskutimet dhe debatet paraprake, përpara se të jepen detyrat konkrete për vitin e ardhshëm, por është e rëndësishme që të kemi edhe një staf profesional të Kuvendit që të ketë financimet e duhura, ndoshta duhet të kishim një analizë të veçantë se sa është kapaciteti i Kuvendit, për të bërë këtë rol mbikëqyrës të tij dhe për ta rritur më tej atë që ne synojmë, kontrollin postlegjislativ, sepse mund të jenë disa deputetë shumë të përgatitur që kanë merita për mënyrën se si bëhet raportimi, por në rast se pas muajit maj të 2025-ës do të ndryshojë dhe nuk do të jenë më deputetë, do të detyrohemi të kemi mungesa dhe të krijojmë edhe një herë eksperiencë, ndërkohë që stafi i Kuvendit, nëse është i përgatitur krijon edhe trashëgiminë institucionale për të vijuar më tej edhe pas ndryshimit të një mandati të një deputeti, që themi se e kemi të sigurt që e bën siç duhet mbikëqyrjen.

A ka pasur Kuvendi një analizë se sa është fondi i nevojshëm për të krijuar një institut të vërtetë, për të krijuar ekspertë të fushave në kuadër të integritit? Në shumë raste ne kemi qenë të kërkuar për të ofruar ekspertizë teknike, si në rastin e energjisë dhe nga eksperiencia Kuvendi i kërkon ndihmë përsëri ekzekutivit për të marrë këto komente apo rekomandime që mund të jepen për legjislacionin që vjen nga ekzekutivi, kur ndërkohë që vetë Kuvendi, edhe për fusha të tjera, duhet të ketë ekspertët e tij, duhet të ketë studime, librari dhe shumë më tepër përgatitje për t'u bërë gati për të rritur rolin e tij mbikëqyrës. Ky ishte pak a shumë rekomandimi im dhe shpresoj që ta vazhdojmë më tej këtë diskutim.

Faleminderit!

Emilio Çika – Faleminderit shumë!

Altin Shumeli – Përshëndetje, të gjithëve!

Unë jam Altin Shumeli nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Falënderoj Kuvendin për iniciativën, pasi në konceptin tim personal kjo është një iniciativë që duhet të ishte bërë 15 vjet më parë, por më mirë vonë se kurrë!

Pikë së pari, për ta qartësuar, në vazhdim të asaj që ju thatë, do të shtoja 3 elemente thelbësore që besoj se nga ju janë prekur. Në fund të fundit, ashtu siç e tha edhe kolegu, zoti Denar, institucionet e pavarura në gjykimin e përgjithshëm, qoftë edhe europian, janë institucione, të cilat janë elemente të Kuvendit, të republikave parlamentare, për të parë se si pushtetet e tjera e ushtrojnë këtë funksion apo ligje të caktuara.

Ajo që unë dua të ngre apo të them është se nuk ka të bëjë natyra e institucionit, më tepër ajo ku duhet të fokusohemi, në formën apo mënyrën konkrete të ushtrimit të kontrollit parlamentar. Pavarësisht natyrave të institucioneve të pavarura që kemi, forma apo mënyra e ushtrimit të kontrollit parlamentar duhet të jetë pak a shumë e njëjta.

Së dyti, për sa i përket natyrës së formës së organeve të pavarura apo edhe kushtetuese që ne kemi, të cilat i ndajmë në monokratike apo edhe në kolegjiale, një sugjerim që mund të jepja është se mund të kemi dy aspekte thelbësore, kryesisht te përcaktimi qartësisht të legjislacionit për institucionet e pavarura nëpërmjet formës së zgjedhjes, ose të kryetarit, pra të jetë Kuvendi ai që zgjedh kryetarin, apo në përcaktimin dhe në rolin thelbësor të Kuvendit në ushtrimin, në përgatitjen dhe miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin. Kjo, pasi të paktën nga eksperiencia ime, shpeshherë organet kolegjiale kanë konflikte të brendshme në mënyrën e ushtrimit dhe të kompetencave që organet apo anëtarët e zgjedhur kanë karshi rolit të kryetarit. Mendoj që qartësimi i këtij pozicioni do ta bënte të mundur njëherë e mirë, apo edhe shtjellimi i ligjit për organet kolegjiale, apo edhe te përcaktimi nga ana e Kuvendit për zgjedhjen e kryetarit, do ta zgjidhte këtë pikë.

Së treti, ajo që do të thosha lidhet me transparencën që duhet të ofrohet në shmangien apo në vizionin, në qasjen ndaj publikut të ndikimit të politikës te zgjedhja e funksionarëve. Kjo është një formë, e cila pavarësisht transparencës, të gjitha organet duhet të jenë së bashku, qoftë ekzekutivi, Kuvendi, apo edhe shoqëria civile, e cila duhet të ofrojë sa më shumë informacion në këtë pikë, me qëllim që të ofrojë një qasje besueshmërie më të madhe te publiku. Në punën që jam, ndeshem me faktin që emërimet apo konkurrimet që bën administrata publike për ata, të cilët kanë statusin e nëpunësit civil, mund të paragjykojnë, por në fakt realiteti është krejt tjetër, ata që tentojnë dhe kërkojnë shohin që procesi është i hapur dhe transparent. Duhet një punë pak më e

madhe për të garantuar dhe për t'u dhënë mundësinë për të thënë që ky proces funksionon. Pra, konkurrioni, afrohuni dhe le të fitojë më i miri! Kaq kisha.

Ju falënderoj!

Emilio Çika – Faleminderit!

Elvin Gjevori – Përshëndetje!

Unë jam Elvin Gjevori, jam drejtuesi vendor i projektit zviceran, PACEP, në mbështetje të mbikëqyrjes parlamentare. Unë gjithmonë vij me kënaqësi në këto tryeza, sepse marrim edhe ide për projektin.

Doja vetëm të thosha disa gjëra. Fillimisht doja t'ju përgëzoja për analizën, sepse një pjesë e mirë e gjetjeve tuaja janë edhe pjesë e gjetjeve të projektit tonë, por doja ta lidhja me punën që po bëjmë me Kuvendin paraprakisht për t'i adresuar një pjesë prej tyre. Institucionet e pavarura sjellin në Kuvend, çdo vit, një informacion shumë të pasur dhe shumë të gjerë në raportimet e tyre dhe jo gjithmonë ai informacion ka kohën që të përtypet, të analizohet dhe t'u jepet deputetëve në një mënyrë thjeshtësisht të lexueshme që të afektojë politikëbërjen, të afektojë analizën e tyre të problematikave. Në bashkëpunim me administratën e Kuvendit dhe Kryetaren e Kuvendit ne do të punojmë me kapacitimin e administratës së Kuvendit që këto raportime që vijnë të analizohen në kohë, të copëzohen, t'u ofrohen deputetëve me metoda analitike që ato mund t'i aksesojnë më thjesht.

Gjithashtu, do të punojmë me katër institucione të pavarura: Avokatin e Popullit, me Komisionerin Kundër Diskriminimit, Komisionerin e së Drejtës së Informacionit dhe me INSTAT-in, për të parë se si ato mund t'i japin informacion Kuvendit, pak më të gjerë, pak më periodik, pak më të targetuar, përveç atij një-vjeçarit që jepet dhe do të punojmë me ato që u përmendën këtu, ndër të tjera po i bie shumë shkurt, me platformën e monitorimit të institucioneve të pavarura, e cila do të bëhet nga e para për të mundësuar që të ndiqen në kohë reale rekomandimet e Kuvendit për institucionet e pavarura, të ndiqen në kohë reale rekomandimet e institucioneve të pavarura për qeverinë, sepse janë 6 institucione që japin rekomandime të tilla dhe për të ndërtuar një platformë komunikimi në kohë reale midis gjithë institucioneve të pavarura, që kanë punë të përditshme me Kuvendin, dhe Kuvendit. Prandaj, ne kemi filluar punën dhe së shpejti besoj do të keni komunikim nga Kuvendi që do të krijohet rrjeti i koordinatorëve midis institucioneve të pavarura dhe Kuvendit, që të jetë një urë e përhershme komunikimi, të ketë pika kontakti të përhershme, si dhe do të krijojmë një sërë mekanizmesh të tjerë. Puna reale e projektit do të fillojë

në janar, që nga pikëpamja teknike që është një periudhë e mirë, sepse fillojnë zgjedhjet dhe presioni politik është diku tjetër. Ne do të përpiqemi që deri në shtator, kur të vijë legjislatura tjetër, platforma e monitorimit të institucioneve të pavarura të jetë gati për pilotim dhe për zbatim dhe instrumentet që do të punojnë me administratën e Kuvendit dhe me administratën e katër institucioneve të pavarura të jenë gjithashtu gati të pilotueshme, për të parë mundësinë për ta zgjeruar edhe më tej. Kaq kisha, në mënyrë shumë telegrafike.

Faleminderit!

Emilio Çika – Faleminderit, zoti Gjevori!

Dikush tjetër? Do të doja t’ia jepja fjalën zonjës Bushka për përmbledhje.

Klotilda Bushka – Shumë faleminderit, zoti Çika, Gledis, Kristi dhe të gjithë ekspertëve!

Shumë faleminderit, të gjithë pjesëmarrësve!

Kjo ishte, me fjalë të parë, nga ato praktikat sesi vlerësohet aktiviteti, me një fjalë, ishte një tryezë e gjallë.

Ju falënderoj të gjithëve për të qenurit kaq konstruktiv dhe të përkushtuar për të dhënë ide dhe sugjerime, të cilat vlejnë për punën që është bërë!

Është bërë një vlerësim i parë i rolit monitorues të Kuvendit dhe i proceseve përzgjedhëse, duke marrë në konsideratë nga ana e ekspertëve raportet dhe rekomandimet e BE-së në kuadër të rrugëtimit të Shqipërisë në familjen europiane, si dhe raportet e tjera të programeve që bashkëpunojnë me Kuvendin, në kuadër të fuqizimit të këtij roli që ka vetë pushteti legjislativ. Të them të drejtën kur ju dëgjoja në komentet dhe sugjerimet kuptoj që ka nevojë të zgjerohemi për t’i dhënë vlerë në dy aspekte këtij materiali. E para, për të përfshirë zërin e institucioneve të pavarura. E dyta, për të bërë të mundur që standardet më të mira të BE-së t’i vishen punës së përditshme të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Është shumë e vërtetë që institucionet kanë specifikat e veta. Kur flasim për funksionin monitorues, shpeshherë ka edhe një mungesë të konceptit të mënyrës së si do të ushtrohet ai dhe kjo lind nga nevoja për të njohur secilin institucion në natyrën e vet.

Funksioni monitorues i Kuvendit, dhe më vjen mirë që këtu u ngrit disa herë, ka të bëjë me diversifikimin e mënyrës se si duhet të ushtrohet ky rol. Ne kemi vetëm një manual njësoj për monitorimin parlamentar, pa marrë në konsideratë natyrën e veçantë të institucioneve. Duhet të kemi të gjithë parasysh se Kuvendi ka një rol monitorues për qeverinë dhe për organet ligjzbatuese, që janë në varësi të pushtetit ekzekutiv dhe ky është një rol specifik. Ne e cekëm tek tryeza e

pardjeshme për sa i takon funksionit ligjvënës dhe këtu rëndësi të madhe patjetër që merr monitorimi se si zbatohen ligjet, sa efektivitet kanë ato në praktikë, sa mbërrijnë parashikimet ligjore në të mira për qytetarët dhe për interesin publik. Nga ana tjetër kemi një funksion monitorues që lidhet me institucionet e pavarura, dhe këtu do të ndalem pastaj më gjerë, dhe një grup tjetër, që janë organet e sistemit të drejtësisë. Ky nuk është një grup që e monitoron Kuvendi, ky është një pushtet i pavarur. Kuvendi ka një rol të përcaktuar qartë në Kushtetutë, i cili normohet nga parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve. Thënë këtë, për të hyrë te roli kryesor i monitorimit të institucioneve të pavarura është e vërtetë që kur kemi qenë studentë, dhe gjithmonë profesoreshë Aurela më kujton me të njëjtin pasion si sot, edhe kur bënim leksionet, se është më se e vërtetë që institucionet e pavarura kanë lindur në shekuj si një nevojë e kuvendeve, e pushteteve legjislative për të kontrolluar me ekspertizën e duhur, me kohën dhe dedikimin e vet fusha të caktuara të veprimtarisë të shoqërisë.

Pra, kur themi Avokati i Popullit, Avokati i Popullit ka lindur si nevojë e shoqërive për të monitoruar në mënyrë më rigoroze, më të dedikuar të zbatimit të të gjithë mekanizmave të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Dhe thënë këtë, ka disa institucione si Avokati i Popullit, të cilët janë mekanizma të demokracisë nga ku mund të përfitojë pushteti legjislativ që ta ushtrojë rolin e vet në mbrojtje të interesave qytetare më mirë. Dhe është një grup institucionesh të tilla siç janë të gjitha institucionet e barazisë, si: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Unë i falënderoj të gjithë për praninë dhe pjesëmarrjen këtu dhe në këtë proces të rëndësishëm! Kuvendi edhe këtu ka një rol jo vetëm që të dëgjojë raportimet, të bëjë atë procesin që, siç e thashë, në manual e kemi për të gjithë njësoj, por do të duhet ta identifikojmë me grup institucionesh, por edhe secili institucion të ketë atë specifikën e vet për mënyrën sesi raporton dhe si merr në konsideratë, por edhe me një rol specifik sesi rekomandimet e institucioneve të pavarura për qeverinë apo për institucionet e tjera të pavarura, për pushtetet e tjera, siç është drejtësia, merren në konsideratë dhe zbatohen.

Mekanizmat shtrëngues janë në ligj në disa raste, prandaj bëhet dhe kjo punë për të kuptuar se cilat janë ato gjetje pozitive që kemi pasur dhe si mund t'i replikojmë në institucione të tjera. Ndaj, e çmoj shumë të rëndësishëm këtë rekomandim që në fakt në këtë tryezë doli pothuajse nga të gjithë, dhe këtu do të jetë edhe fokusi i punës së Kuvendit, se sa Kuvendi është i aftë që rekomandimet e institucioneve të pavarura janë të zbatueshme dhe çfarë detyrash ka Kuvendi që

ato rekomandime të zbatohen në mënyrë të plotë. Siç kemi pasur raste të rekomandimeve të Avokatit të Popullit sa i takon sektorit të të drejtave të të burgosurve apo në paraburgim. Siç kemi tani një rekomandim shumë të rëndësishëm për të drejtat e njeriut dhe garancitë procedurale në proceset penale. Janë të gjitha këto rekomandime që nëse nuk ka një rol Kuvendi, nuk do të jenë efektive në zbatim, për të dhënë ca shembuj dhe për të kuptuar. Por, të njëjtën gjë do të duhet ta bëjmë me të gjitha institucionet.

Elvini e tha me të drejtë se platforma digjitale është shumë e rëndësishme, sepse institucionet atje ndërveprojnë me njëri –tjetrin për të kuptuar se ku janë me nivelin e zbatimit të rekomandimeve; mund edhe të krijojnë forume dialogu. Dhe thënë këtë, bie shumë dakord me qasjen që me institucionet e pavarura duhet të diskutohet, të ezaurohen nëpër komisionet përgjegjëse parlamentare për të gjitha çështjet dhe të bihet dakord për rekomandimet, sepse roli midis Kuvendit dhe institucioneve të pavarura duhet të jetë ndërveprues. Patjetër që ka një moment të llogaridhënies dhe të kërkesës të llogarisë për efektivitetin, por, së pari, ne do të duhet të dialogojmë dhe më pas të kuptojmë sesi bëhen sa më efektive të gjitha rekomandimet që jepen nga institucionet e pavarura, por edhe nga Kuvendi për institucionet e pavarura, se kështu shkon niveli i përgjegjshmërisë, i kontrollit dhe në fund përfiton interesi publik.

Thënë këtë në Kuvend ka tashmë një proces për rinergjizimin e strukturave me shumë programe, por edhe me një nismë të Kryetares së Kuvendit për një ristrukturim, për një vlerësim të një ristrukturimi të Kuvendit sa i takon rritjes së kapaciteteve të Kuvendit në të gjitha funksionet që ne ushtrojmë. Paralelisht, ky komision i posaçëm po kontribuon në mënyrë të posaçme në këtë funksion, i cili, përveç planit të brendshëm, i shërben dhe procesit të integritetit në Bashkimit European.

Unë do të doja që materialet që do të prodhohen, me të drejtë siç e ngriti edhe Akademia e Studimeve Politike, nëse nuk gaboj, zoti Tase, do të duhet të ndahen me pjesëmarrësit dhe të gjitha institucionet e pavarura. Pse jo, një metodologji duhet shtuar, takimet e veçanta me fokus grupe, me institucione ndoshta jo individuale, por sipas natyrave që kanë për të marrë mendime edhe më konkrete për pasurimin e materialit të analizës dhe materialeve vijuese që vijnë më tej.

Sa i takon procesit zgjedhës, jam shumë dakord me gjithçka që tha profesoreshë Aurela dhe do të doja që analiza të fokusohet në momentin kur propozimet bëhen edhe duke pasur si “*Benchmark*” të gjithë rekomandimet e Komisionit të Venecies, të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në përputhje me kapacitetet reale që ka vendi.

Tashmë kemi rezultate shumë të mira të arritura nga reforma në drejtësi. Kemi sfida, të cilat na kanë treguar se çfarë mund të përmirësojmë dhe do të duhet t'i marrim në konsideratë të gjitha kur të japim rekomandimet përfundimtare në lidhje me fokusin e punës që ka ky grup në shtyllën e shtetit të së drejtës.

Do të doja edhe një herë t'ju falënderoja të gjithëve!

Edhe pse zgjasin diskutimet, nuk mendoj se ka proces më të shëndetshëm sesa ky, ku të gjithë flasim hapur. U japim jetë atyre mekanizmave që demokracia na ka dhënë si mundësi për t'i shërbyer shoqërisë dhe për të bërë diçka që pavarësisht se kush ulet në këto tryeza nesër, stafet, administrata, mentaliteti, rregullat të jenë të shkruara, të sanksionuara, të detyrueshme, në mënyrë që të shpërndahen me vite standarde të qëndrueshme që vetëm e përmirësojnë demokracinë.

Faleminderit, edhe një herë!

Fjalën ua lë ekspertëve.

Mos më shani që e zgjata shumë.

Emilio Çika – Faleminderit, zonja Bushka!

Do të doja që në emër të ekspertëve, meqë përgatitën materialin, të falënderoja të gjithë pjesëmarrësit për komentet, sugjerimet e vyera!

Ashtu siç tha edhe zonja Bushka është një draftmaterial, një draftanalizë, e cila do të përmbushet me propozimet dhe sugjerimet tuaja, të cilat, siç ju thashë, janë shumë të vyera, në mënyrë që të dalim përfundimisht me një material, i cili do të ketë që të gjitha kërkesat në njëfarë mënyre dhe sugjerimet, të cilat do të vijnë nga institucionet që ju përfaqësoni.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen, edhe një herë!

Shihemi në takime të tjera.

MBYLLET MBLEDHJA

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Koordinator i Komisionit